



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 11 Akti

Nr. 34 Vendimi

Tiranë, më 11.07.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi

Kryesuese

Lulzim Hamitaj

Relator

Olsi Komici

Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Denisa Kosta, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në Tiranë, në datat 28 qershor 2018, ora 10:00, 2 korrik 2018, ora 14:00, dhe 11 korrik 2018, ora 09:30, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Artan Sabaudin Lazaj, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga avokati Sokol Hazizaj, avokat i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE :

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Lulzim Hamitaj; subjektin e rivlerësimit dhe përfaqësuesin e tij; vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit Artan Lazaj, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 02.07.2018 kërkoi konfirmimin e tij në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Z. Artan Lazaj është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim referuar si “Ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se: *“Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryespektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio”*.

Subjekti i rivlerësimit, duke qenë kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në bazë të nenit 284 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtuar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt rivlerësimi më datë 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit”, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim i referuar si “Komisioni”).

Pas hedhjes së shortit, trupi gjykuese nr. 3, pasi administroi dhe studioi tri raportet e institucioneve të parashikuara nga nenet 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr.1, datë 14.12.2017, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohet kryesuesi i trupit gjykuës, znj. Brunilda Bektashi. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykuës deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

Më datë 06.06.2018, trupi gjykuës, me anë të vendimit nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Lazaj, vetëm për kriterin e pasurisë, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes.

Më datë 07.06.2018, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për të sjellë prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) përbërjen e trupit gjykues, me ftesën që duhej të deklaronte nëse kishte konflikt interesi me ndonjërin nga anëtarët e tij.

Më datë 21.06.2018, subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

Më datë 22.06.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Artan Lazaj, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 28.06.2018, ora 10:00.

Më datë 28.06.2018, u zhvillua seanca dëgjimore ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent, bashkë me përfaqësuesin e tij ligjor.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Lazaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.

Në fillim të seancës dëgjimore, të datës 28.06.2018, subjekti i rivlerësimit, - nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, - paraqiti një kërkesë për revokimin e vendimit të mbylljes së hetimit vetëm për kriterin e pasurisë, si dhe të caktimit të seancës. Gjithashtu, nëpërmjet të njëjtit dokument, ai kërkoi që të kryhej përfundimi i hetimit edhe për dy kriteret e tjera.

Në vijim të kësaj kërkesë, trupi gjykues u tërhoq në dhomën e këshillimit me praninë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe vendosi mospranimin e kësaj kërkesë, pasi ishte e pabazuar në ligje dhe në fakte, për shkak se vendimi i trupit gjykues për caktimin e seancës dëgjimore, pas mbylljes së hetimit vetëm për një kriter rivlerësimi, ishte i bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

Menjëherë pas leximit në sallë të vendimit për rrëzimin e kërkesës së sipërcituar, z. Lazaj paraqiti një tjetër kërkesë, këtë herë për përjashtimin e trupit gjykues, pasi – sipas tij – të gjithë anëtarët e trupit e kishin paragjykuar subjektin e rivlerësimit, duke caktuar seancën dëgjimore pas mbylljes së hetimit vetëm mbi një kriter.

Trupi gjykues, pasi u tërhoq përsëri në dhomën e këshillimit, në praninë e vëzhguesit ndërkombëtar, në mbështetje të Rregullores së Komisionit, vendosi të administrojë kërkesën në fjalë dhe të shtyjë seancën në datën 02.07.2018, në pritje të vendimit, që do të jepej nga një trup gjykues që do të shortohej për këtë qëllim.

Në çeljen e seancës së datës 02.07.2018, kryesuesja e trupit gjykues citoi dispozitivin e vendimit me nr. 5001 prot., të marrë nga trupi gjykues i shortuar më datë 29.06.2018, që kishte rrëzuar kërkesën për përjashtim, në bazë të Rregullores së Komisionit, si dhe të nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative – vendim i cili i ishte komunikuar paraprakisht me *e-mail* subjektit të rivlerësimit.

Në vijim, z. Lazaj paraqiti një tjetër kërkesë. Këtë herë për përjashtimin e kryesueses, znj. Bektshi, pasi – sipas tij – kjo e fundit në vitin 2016, në ushtrim të funksionit si përfaqësuese ligjore e kompanisë ku asokohe ajo punonte, kishte kërkuar përjashtimin e z. Lazaj, që kishte funksionin e gjyqtarit të çështjes. Gjithashtu, z. Lazaj deklaronte se këtë fakt ai e kishte mësuar vetëm në ditën e seancës (më datë 02.07.2018), në sajë të komunikimit që i kishte bërë kancelari i Gjykatës së Tiranës.

Trupi gjykues, pasi u tërhoq në dhomën e këshillimit, në praninë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, shqyrtoi kërkesën në fjalë, rrethanat në të cilat ajo bazohej, shkakun dhe efektet e mundshme mbi procesin e rivlerësimit, bazuar në nenet 34 dhe 74 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në Rregulloren e Komisionit, vendosi që ta prapësonte atë - duke mos qenë rasti për t'ia kaluar një tjetër trupi gjykues për shqyrtim dhe vendimmarrje, pasi ajo rezultonte qartazi e vonuar dhe në mosrespektim të pikës 3 të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, si dhe e papranueshme, pasi nuk bazohej mbi fakte të reja. Gjithashtu, kjo kërkesë rezultonte me tendenca për zvarritjen e procesit të rivlerësimit.

Në fakt, bëhej fjalë për një rrethanë që z. Lazaj e kishte njohur/përjetuar në vitin 2016 dhe nëse ajo kishte nuanca konflikti, ai do ta kujtonte më parë. Në çdo rast, ai i kishte pasur të gjithë kohën dhe të gjitha mundësitë që të konstatohej ekzistencën e çdo lloj konflikti të mundshëm, menjëherë pasi ishte njohur me emrat e anëtarëve të trupit gjykues dhe, nëse ishte rasti, të paraqiste kërkesën për përjashtim menjëherë, në përputhje me pikën 3 të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, dhe jo në seancën e dytë dëgjimore.

Me rifillimin e seancës, fjala i kaloi relatorit, i cili shpalosi të gjitha rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë hetimeve të kryera dhe vlerësimit të dokumentacionit në dispozicion.

Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, z. Artan Lazaj shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse të detajuara, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Më pas, subjekti i rivlerësimit iu përgjigj pyetjeve të bëra nga trupi gjykues.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit depozitoi pranë Komisionit parashtrimet e tij me shkrim, në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ, si dhe dokumentacionin mbështetës, të cilat ishin pothuajse të njëjta me ato të paraqitura prej tij pas kalimit të barrës së provës. Në fund të seancës dëgjimore, z. Artan Lazaj shprehu qëndrimin e tij përfundimtar të argumentuar dhe në konkluzion kërkoi konfirmimin e tij në detyrë.

Seanca dëgjimore e datës 02.07.2018 u ndërpre për të rifilluar më datë 11.07.2018, për shpalljen e vendimit.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në bazë të të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.”*, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Lazaj, duke u bazuar vetëm mbi kriterin e pasurisë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Artan Lazaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

Por, siç u tha edhe më lart, përgjatë seancës dëgjimore u konstatua një tentativë për të zvarritur procesin, nëpërmjet një sërë kërkesash strategjike të paramenduara dhe të parapërgatitura, pavarësisht faktit që vetë z. Lazaj, si dhe përfaqësuesi i tij, e njihnin - ose duhet të njihnin - pabazueshmërinë e kërkesave të paraqitura, si dhe shkaqet e mospranimit të kërkesës së fundit, për mungesë të një fakti të ri, i vetmi që mund ta legjitimonte subjektin e rivlerësimit për paraqitjen e saj – siç u pretendua/tentua që të konsiderohej një fakt që kishte ndodhur në vitin 2016 dhe që subjektit i rivlerësimit kishte marrë dijeni qysh atëherë mbi atë rrethanë që e përfshinte personalisht.

Në lidhje me këtë sjellje, trupi gjykues rezervoi të drejtën mbi vendosjen e mundshme të një gjobe, në bazë të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI; c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; ç) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; d) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në datën 05.06.2018, si dhe në seancë dëgjimore - për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; dh) deklaratimet e personave të tjerë të lidhur, e) faktet e njohura botërisht.

PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar me shkresën nr. 117/27 prot., datë 13.11.2017,

raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Artan Lazaj, ku konstatohet se:

- Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- Nuk ka burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- Ka kryer deklaratim të rremë;
- Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi: në verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, i ligjit nr. 84/2016.

Mbi asetet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 84/2016

Pasuri e paluajtshme:

- 1. Apartament banimi, me sipërfaqe 158.1 m², me adresë: “***”, pall. “***”, h. ***, ap. ***, Njësia nr. ***, Tiranë.**

Ky apartament rezulton i përfituar nëpërmjet kontratës së porosisë/premtim shitblerjeje me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., të nënshkruar në datën 19.11.2010. Çmimi i këtij apartamenti, në Deklaratën-Vetting është deklaruar 129.000 euro dhe pjesa takuese 25 %, ndërsa burimi i të ardhurave të përdorura për blerjen e kësaj pasurie nuk është përshkruar në këtë deklaratim.

Në lidhje me këtë pasuri, nga hetimi kryesisht është konstatuar se ajo nuk ka qenë e deklaruar në vitin përkatës të blerjes, - pra në deklaratën periodike të vitit 2010, - por vetëm në vitin 2011, ku çmimi i blerjes është shënuar në vlerën 120.000 euro dhe pjesa takuese 100 %, ndërkohë që në Deklaratën-Vetting, siç u tha edhe më lart, çmimi ishte deklaruar 129.000 euro dhe pjesa takuese 25 %.

Ndërsa në kontratën e sipërpërmendur çmimi rezulton 129.000 euro, i cili do të paguhej si vijon: shuma prej 79.000 eurosh ishte likuiduar jashtë zyrës noteriale, ndërsa shuma e ngelur prej 50.000 eurosh do të shlyhej brenda muajit janar 2011, ashtu si palët ishin akorduar përpara noterit.

Në deklarin periodik të vitit 2011, si burim financiar për blerjen e këtij apartamenti është deklaruar: *“Pjesërisht nga shitja e një tjetër apartamenti dhe pjesa e ngelur nga një kredi prej 4.000.000 lekësh dhe nga kursime nga pagat”* - pa specifikime të mëtejshme.

Nga sa më lart, rezultojnë mospërputhje midis Deklaratës-Vetting dhe deklaratës së vitit 2011, si dhe midis të dhënave të këtyre dy deklaratave dhe përmbajtjes së kontratës së porosisë, si më lart. Në Deklaratën-Vetting nuk është përshkruar burimi i të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti. Gjithashtu, ka pasur një deklarin të pamjaftueshëm në vitin 2010, pasi në këtë deklarin periodik subjekti i rivlerësimit do të duhej të kishte deklaruar apartamentin e blerë, por ka rezultuar se ky deklarin nuk është kryer nga ana e tij. Po ashtu, kanë rezultuar mospërputhje midis dy çmimeve të deklaruara, të pasqyruara me shifra të ndryshme në Deklaratën - Vetting, në krahasim me sa ishte deklaruar në vitin 2011, si dhe në lidhje me datat/vitet e kryerjes së pagesave në fjalë. Edhe në Deklaratën-Vetting, siç u tha edhe më lart, ka rezultuar një mungesë e deklarin të burimeve financiare të përdorura për blerjen e apartamentit në fjalë.

Në lidhje me këto mospërputhje është pyetur subjekti i rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit të dytë, i cili, në përgjigje të pyetjes nr. 7, ka pohuar: *“Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 177 m² kontratë sipërmarrjeje e lidhur me shoqërinë “***” sh.p.k. për këtë apartament, nuk është lidhur ende kontratë shitjeje. Mënyra e pagesës është kryer sipas deklaratës së datës 21.03.2018, të lëshuar nga kjo shoqëri”*.

Në deklaratën e mësipërme, të “***” sh.p.k., së cilës i referohet subjekti i rivlerësimit, veç të tjerash, shkruhet: *“Në momentin e lidhjes së kontratës është likuiduar shuma prej 3.900.000 lekësh dhe shuma prej 50.000 eurosh është likuiduar nëpërmjet pagesës në bankat e nivelit të dytë. Vlera e mbetur është likuiduar me këste gjatë viteve, deri në vitin 2014, për të cilat mungon evidenca, pasi arkiva e shoqërisë nuk është më e disponueshme”*.

Ndërsa, në vijim të hetimeve të Komisionit, rezultoi një dokument bankar i lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, me përmbajtje: *“Kërkesë për transfertë fondesh” me përfitues “***” sh.p.k., rezulton e paguar shuma prej 3.900.000 lekësh, me urdhërues z. Artan Lazaj, me përshkrimin “Likuidim detyrimi” më datë 17.08.2009.*

Nga sa më sipër, rezultojnë mospërputhje me deklaratën periodike të vitit 2009, ku subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë veprim bankar - likuidim detyrimi në shumën prej 3.900.000 lekësh në favor të “***” sh.p.k., sipas dokumentit bankar të sipërpërmendur¹, pasi ai ka deklaruar që pjesa e parë e pagesës ishte kryer në momentin e lidhjes së kontratës (19 nëntor 2010) dhe jo në vitin 2009. Pra, në deklaratën periodike të vitit 2009 nuk është deklaruar ky shpenzim i konsiderueshëm prej 3.9 milionë lekësh.

Gjithashtu, e njëjta situatë paraqitet në lidhje me pagesën prej 50.000 eurosh, - që në deklaratën e lartpërmendur, të bërë nga “***” sh.p.k. nuk specifikohet se kur është kryer, - ndërsa nga

¹Në vijim të kërkesës së Komisionit, “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 12.01.2018, ka dhënë informacion në lidhje me llogaritë bankare për subjektin e rivlerësimit, dhe konkretisht për z. A. Lazaj: Raiffeisen Bank *“Kërkesë për transfertë fondesh” me përfitues “***” sh.p.k. rezulton e paguar shuma prej 3.900.000 lekësh, me urdhërues z. Artan Lazaj, me përshkrimin “Likuidim detyrimi” më datë 17.08.2009.*

dokumentacioni bankar², i administruar nga Komisioni, rezulton se kjo shumë është paguar më datë 18.08.2010. As ky veprim bankar, pra ky shpenzim prej 50.000 eurosh, i kryer në vitin 2010, nuk është deklaruar te formulari i posaçëm që pasqyron shpenzimet, në deklaratën periodike të këtij viti. Pagesat e mësipërme, për sa i përket momentit të kryerjes së tyre, bien ndesh me deklaratimet noteriale të bëra në pikën 4 të kontratës së sipërmarrjes, nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 19.11.2010. Po ashtu, ka mospërputhje midis tyre dhe përmbajtjes së deklaratës së bërë nga “***” sh.p.k., në datën 21.03.2018. Kështu që rezulton se deklaratimet noteriale në fjalë nuk kanë pasqyruar realitetin e fakteve, për rrjedhojë ato nuk kanë qenë të vërteta, pra jemi përballë një deklarimi noterial të rremë.

As nga përgjigjet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në pyetësorin e Komisionit nuk qartësohen apo sheshohen mospërputhjet, siç u tha edhe më lart, ato vijnë të ekzistojnë dhe madje të shtohen. Në fakt, kanë rezultuar të tjera mospërputhje midis deklaratës së datës 21.03.2018, - së cilës subjekti i rivlerësimit i referohet, pra duke e bërë të vetën përmbajtjen e saj, - dhe deklarimeve të tij periodike. Gjithashtu, disa elemente të deklaratës në fjalë bien ndesh me veprimet bankare, që sipas dokumentacionit përkatës (shih referencat nr. 1 dhe nr. 2) rezultojnë të kryera në periudha kohore të ndryshme nga sa pretendohet nga subjekti i rivlerësimit. Po ashtu, nuk rezultojnë të provuara, as të deklaruara ndër vite në deklaratat periodike respektive dhe as nga dokumentet bankare, pagesat e pretenduara se janë kryer me këste deri në vitin 2014, për likuidimin e çmimit të kësaj pasurie.

1.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me mospërputhjet e deklarimeve mbi këtë pasuri

Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet përgjigjeve dhe sqarimeve që ka dërguar me anë të postës elektronike³, si dhe nëpërmjet shpjegimeve të tij, të gjata dhe të detajuara, të dhëna në seancën dëgjimore të datës 02.07.2018, nuk ka arritur të hedhë mjaftueshëm dritë mbi:

- shumë mospërputhje datash, periudhash, vitesh në lidhje me pagesat e kryera prej tij, për likuidimin e çmimit të kësaj pasurie;
- mbi arsyet e mosdeklarimit të kontratës së premtim-shitjes, në vitin 2010 apo të mosdeklarimeve, të deklarimeve të gabuara, të pamjaftueshme dhe të pasakta, në lidhje me veprimet bankare dhe me pagesat e kryera jashtë sistemit bankar, në favor të “***” sh.p.k., si vijon:
 - datën/vitin e disa pagesave dhe burimin e të ardhurave të përdorura për pagesën e çmimit të kësaj prone dhe konkretisht të pjesës së ngelur si detyrim, pasi ishin paguar shumat prej 3.9 milionë lekësh dhe 50.000 eurosh - që sipas tij dhe shoqërisë “***” sh.p.k., kjo diferencë është paguar deri në vitin 2014. Por, si veprime të demonstruara rezultojnë vetëm pagesat prej 3.9 milionë lekësh (17.08.2009) dhe 50.000 eurosh (18.08.2010). Kështu që pjesa e mbetur pa u likuiduar, nga çmimi

² Në përgjigje të kërkesës së nisur nga Komisioni, “BKT”, me shkresën nr. *** prot., datë 16.03.2018, ka konfirmuar veprimin bankar të subjektit të rivlerësimit - derdhje në datën 18.08.2010, në llogari të “***” sh.p.k., në shumën prej 50.000 eurosh.

³Referojuni përgjigjeve të pyetësorëve; parashtrimeve/prapësimeve, si dhe shpjegimeve verbale të subjektit të rivlerësimit, në seancën e datës 02.07.2018.

prej 129.000 eurosh, nuk është deklaruar nga subjekti, në asnjë deklaram periodik të pasurive të tij, as si detyrim dhe as si pagesa të kryera (në vitet 2010 - 2014). Veç të tjerash, edhe nëse pjesa e mbetur është paguar (realisht), nuk dihet kur janë kryer pagesat, nga kush dhe cili ka qenë burimi financiar i shumave të paguara, pasi sipas analizës financiare, vitet 2010 - 2014 dalin me bilanc negativ, – dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar të kundërtën.

Në lidhje me sa më lart, subjekti i rivlerësimit, edhe pse argumentoi gjatë dhe pa ndërprerje, duke i sqaruar në detaje të gjitha aspektet që ai vlerësoi të shpjegonte, arriti të provonte mungesën e përgjegjësisë nga ana e tij vetëm në lidhje me përshkrimin (e gabuar) të burimit “nga emigracioni” të shumës prej 50.000 eurosh, e cila ishte paguar nga ai, me transfertë bankare, në datën 18.08.2010, në favor dhe në llogari të “***” sh.p.k. Ky përshkrim (“nga emigracioni”) me sa duket ka qenë një gabim material i një punonjëse të bakës ku ishte kryer veprimi, e cila kishte zgjedhur gabimisht në sistemin kompjuterik zërin “emigracion”, edhe pse këtë zgjedhje/deklaram, sipas deklaratës së bankës⁴, nuk e ka bërë z. Lazaj.

Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, mbi veprimet e kryera në lidhje me këtë pasuri është shprehur se:

- Të ardhurat për pagesën e kësaj pasurie, si edhe për të gjitha të tjerat, ai i ka pasur të ligjshme. Shuma prej 3.900.000 lekësh (28.457 euro⁵) ishte paguar me të ardhurat nga kredia e marrë në “Raiffeisen Bank”, ndërsa shuma prej 50.000 eurosh (e paguar më 18.08.2010) e kishte burimin totalisht nga pjesa e ngelur e çmimit të shitjes së apartamentit të tij. Për sa i përket pjesës tjetër të ngelur si detyrim nga çmimi i apartamentit në “***” - sipas tij - ishte paguar në këtë mënyrë: me 1.5 milion lekë që kishin tepruar⁶ nga shuma prej 90.000 eurosh, e përfituar nga shitja e apartamentit tjetër (në Rrugën e ****) dhe vlera e mbetur nga kursimet e tij dhe të bashkëshortes⁷.
- Në lidhje me mosdeklarimet dhe me deklarimet e pamjaftueshme apo të pasakta, ai shprehet që pranon se ka bërë gabime të shumta, por që ato janë harresa, neglizhenca ose pasaktësi, nuk janë veprime të qëllimshme dhe nuk kanë pasur si objektiv apo pasojë fshehjen e pasurisë.
- Në lidhje me mospërputhjen e çmimit të deklaruar prej tij (120.000 euro) dhe çmimit që rezulton në kontratën e sipërcituar (129.000 euro), subjekti i rivlerësimit pohoi se ai fillimisht kishte folur me ndërtuesin për blerjen e apartamentit me një çmim prej 120.000 eurosh, por më vonë, çmimi ishte rritur me 9.000 euro, pasi kjo shifër ishte shpenzuar nga

⁴ Sipas deklaratës së Bankës Kombëtare Tregtare, të lëshuar në qershor 2018.

⁵ Sipas kursit të vitit 2009, shuma prej 3.903.500 lekësh ishte e barabartë me 28.457 euro, pasi raporti lekë – euro ishte 137.17 lekë/ 1 euro - burimi kursi e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në vitit 2009.

⁶ Kjo tezë – e shprehur nga subjekti i rivlerësimit (faqja 21 e procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 02.07.2018), nuk përputhet me atë që ai ka deklaruar në faqen 3 të deklaratës së vitit 2008 – ku pohon se, pas shlyerjes së kredisë në “Alpha Bank” (pas pagesës së 2.5 milionë lekëve), dhe blerjes së një autoveture, i kishte ngelur gjendje *cash* në shumën prej 60.000 eurosh. Pas pagesës së mëtejshme prej 50.000 eurosh (më 18.08.2010), nuk mund të ngeleshin 1.5 milion lekë.

⁷ Në ato vite subjekti i rivlerësimit ka dalë me bilance negative dhe për rrjedhojë nuk është provuar nga ai se cilat kursime kanë bërë të mundur pagesën e pjesës së ngelur të çmimit (prej 50.543 eurosh), deri në likuidimin total të shumës prej 129.000 eurosh.

“***” sh.p.k. për mobilimin e apartamentit në fjalë. Këtë rrethanë e ka pohuar edhe përfaqësuesi ligjor i “***” sh.p.k., nëpërmjet deklaratës private të datës 19.06.2018.

1.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Subjekti, në seancën dëgjimore të datës 02.07.2018⁸ ka deklaruar – duke konfirmuar sa kishte thënë edhe me përgjigjen e pyetjes nr. 10 të pyetësorit të datës 24.03.2018 – se, në sajë/vijim të kontratës së parë (të vitit 2008) për premtim-shitjen e apartamentit në Rrugën e *** (Tiranë), në vitin 2008 ai kishte përfituar vetëm shumën prej 2.500.000 lekësh, që pastaj e kishte derdhur në “Alpha Bank” për shlyerjen e kredisë së mbetur, pra nuk kishte gjendje të ardhurash nga nga shitje, deri në muajin nëntor të vitit 2010, kur është bërë kontrata e dytë për premtimin e shitjes së të njëjtit apartament.

Nëse i konsiderojmë të mirëqena këto deklarime (të shprehura në seancën dëgjimore dhe nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorëve) - të cilat nuk kundërshtohen nga fakte konkrete, që mund të provojnë të kundërtën, - rrjedhimisht arrijmë në konkluzionet e mëposhtme:

- a- Nuk është deklaruar shpenzimi prej 4.900.000 lekësh, i kryer në vitin 2009 dhe as ai prej 50.000 eurosh i bërë në vitin 2010 – të dy në favor të “***” sh.p.k.
- b- Nuk kishte burime financiare të ligjshme në datën 18 gusht 2010 për pagesën e 50.000 eurove, pasi të ardhurat nga shitja e shtëpisë, e kryer më 19 nëntor 2010, ishin të disponueshme vetëm tre muaj më vonë.
- c- Mungesë deklarimi të posedimit/disponibilitetit *cash*, prej 50.000 eurosh dhe të burimit të tyre. Kjo sasi likuiditeti duhej të ishte deklaruar gjendje *cash* e mbartur në datën 31.12.2009 – pra në deklaratën e këtij viti, me specifikimin e burimit të kësaj shume, duke u nisur nga fakti që, në datën e kryerjes së pagesës në fjalë, nuk disponohej ende shuma e përfituar nga shitja e apartamentit në Rrugën e *** , Tiranë.
- d- Është bërë deklaratë e rreme në vitin 2008, kur në faqen nr. 3 është deklaruar një gjendje *cash* 60.000 euro, si pjesë e ngelur nga shuma prej 90.000 eurove, e përfituar nga shitja e apartamentit (pasi: ishin paguar taksat; ishte shlyer kredia në “Alpha Bank”; ishte blerë një autoveturë);
- e- Nuk janë deklaruar pagesat (që pretendohet) se janë kryer në favor të “***” sh.p.k., përgjatë periudhës 2010 - 2014 –sipas deklaratës së kësaj të fundit, të datës 21.03.2018 - të detyrimit prej 50.543 eurosh (të ngelur si detyrim i subjektit të rivlerësimit nga çmimi i blerjes së apartamentit: $129.000 - 28.457 - 50.000 = 50.543$);
- f- Ka mospërputhje midis deklaratës së “***” sh.p.k., të datës 21.03.2018, të cilën subjekti i rivlerësimit e konfirmon, duke iu referuar asaj dhe duke mbështetur në të disa argumentime të tij, dhe veprimeve të kryera, si dhe deklarimeve periodike në të cilat nuk është specifikuar mënyra/vlera/viti i pagesave (e kësteve të pretenduara).

Ndërsa, nëse do të konsideronim të vërtetë deklarinimin e bërë nga subjekti i rivlerësimit në vitin

⁸ Deklarimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë gjendet në faqet 18-19 të procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 02.07.2018.

2008, mbi përfitimin/marrjen njëherazi në atë vit të çmimit të plotë (prej 90.000 eurosh) të shitjes së apartamentit të Rruga e *** (gjë që do të bënte të rrëzohej i gjithë argumentimi mbrojtës që z. Lazaj shpalosi në seancën dëgjimore, në lidhje me këtë pasuri), atëherë do të arrinim në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit do të justifikonte pagesën prej 50.000 eurosh të bërë me transfertë bankare në vitin 2009, në favor të “***” sh.p.k. Por, nga ana tjetër, nuk do të justifikonte pagesat e detyrimit të ngelur, prej 50.543 eurosh që, – sipas deklarimeve të tij dhe të “***” sh.p.k., pa specifikime të mëtejshme, - janë kryer nga viti 2010 deri në vitin 2014. Mosjustifikimi bazohet në faktin se në këto vite ai ka një bilanc negativ dhe, për rrjedhojë, nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme për t’i mundësuar atij pagesën e shumës në fjalë, prej 50.543 eurosh.

Pikërisht, në lidhje me detyrimin e ngelur, në mungesë të provave konkrete mbi pagesat e kryera për likuidimin e tij, mund të hipotizohet edhe një variant i tretë, që do të ishte ai i mospagesës së kësaj shume nga z. Lazaj. Në këtë rast do të ishim përballë deklarimeve të rreme të dyanshme, si dhe përballë mosdeklarimit të një detyrimi që vijon të ekzistojë akoma, qysh prej vitit 2010, ose të shuarjes/faljes së tij, në sajë të një akordi joformal midis palëve. Këtu do të ishim në kuadrin e një trajtimi preferencial, por që nuk na rezulton që të jetë deklaruar.

Gjithsesi, në konkluzion të arsyetimeve të mësipërme, Komisioni arrin në përfundimin se, nga çdo lloj këndvështrimi që mund të analizohet dhe vlerësohet kjo pasuri, rezulton e provuar ekzistenca e një sërë deklarimesh të pamjaftueshme, kontradiktore midis tyre dhe të paplota, si dhe e mungesës së burimit financiar për pagesën e një shume prej më shumë se 50.000 eurosh, veç mosdeklarimit në vitin 2010 të blerjes së apartamentit në fjalë. Këto veprime rezultojnë të jenë kryer në mosrespektim të ligjit nr. 9049/2003 dhe të ndryshimeve të tij, si dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe që, për rrjedhojë, na çojnë në aplikimin e nenit 61, pika 3, të po këtij ligji.

2. Ish-pasuri e subjektit të rivlerësimit: Apartament në Rrugën e *, Tiranë, me sipërfaqe 120 m² dhe me nr. pasurie 10/179.**

Vlerësimi i kësaj pasurie bëhet në sajë të faktit që në Deklaratën-Vetting, subjekti i rivlerësimit, veç të tjerash, e ka deklaruar atë si burim financiar për blerjen e apartamentit të trajtuar në pikën nr. 1. Konkretisht, ai deklaronte: *“Të ardhura nga shitja e një apartamenti (i cili është blerë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.01.2004). Veprimi i shitjes është kryer me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.01.2010, me çmim 8.420.000 lekë. Nga diferenca midis çmimit të blerjes dhe të shitjes, kam krijuar të ardhura plus”*.

Nga studimi i kontratës me nr. *** rep., nr. *** kol., rezultoi se ajo kishte si datë lidhjeje/nënshkrimi datën 25.08.2004 dhe jo datën 20.01.2004, siç e kishte deklaruar subjekti (si më lart), pra u konstatua një pasaktësi në deklarin në fjalë.

Gjithashtu, nga kontrata e sipërcituar (me shitës shtetasin A. M. dhe blerës z. Artan Lazaj), – që kishte si objekt shitblerjeje pikërisht apartamentin në Rrugën e ***, Tiranë, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, më datë 12.04.2000, – rezultonte se çmimi i shitjes kishte qenë 4.000.000 lekë dhe i likuiduar jashtë zyrës noteriale. Por, në deklaratën periodike të vitit 2004,

subjekti e kishte deklaruar këtë apartament si të blerë me çmimin prej 55.000 eurosh. Për rrjedhojë, rezultoi një mospërputhje midis çmimit të shitblerjes që rezulton nga kontrata, me çmimin që është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

Po ashtu, në Deklaratën-Vetting, në faqen nr. 7, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ai ka pasur një të ardhur prej 8.420.000 lekësh nga “*Veprimi i shitjes që është kryer me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., e datës 20.01.2010. Nga diferenca midis çmimit të blerjes dhe të shitjes kam krijuar të ardhura plus*”.

Duke analizuar këtë kontratë, me palë shitëse z. Artan Lazaj dhe blerës bashkëshortët S. dhe N. A., shitja e apartamentit rezultoi me çmim 90.000 euro, dhe jo 8.420.000 lekë.

Gjithashtu, nga hetimet e kryera rezultoi se subjekti i rivlerësimit, për të njëjtin apartament ka nënshkruar dy kontrata premtim-shitjeje, me të njëjtat palë blerëse dhe me të njëjtin çmim, si dhe me aktet e shitblerjes të kryera dhe të firmosura nga i njëjti noter. Pra, veç kontratës së sipërcituar, ekzistonte edhe një tjetër kontratë që në vitin 2008, dhe konkretisht: “*Kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 05.09.2008, me shitës z. Artan Lazaj dhe blerës S. dhe N. A., me sipërfaqe 120 m², ZK 8310, me çmim shitjeje 90.000 euro (likuiduar jashtë zyrës noteriale).*”

Pra u konstatua se nga subjekti i rivlerësimit është kryer një veprim noterial fiktiv, pasi janë bërë dy kontrata për shitjen e të njëjtit apartament, në 2008-ën dhe në 2010-ën, përpara të njëjtit noter, me të njëjtat palë dhe me të njëjtin çmim.

Gjithashtu, në vijim të pyetësorit të nisur nga Komisioni në datën 24.03.2018, subjekti i rivlerësimit, – në pikën 3 të përgjigjes në lidhje me pyetjen nr. 10, – duke iu referuar kontratës së vitit 2008 për apartamentin në fjalë, deklaroi se: “*Faktikisht nga ana e blerësve janë paguar vetëm 2.500.000 lekë, me të cilat është paguar pjesa e mbetur e kredisë së marrë tek “Alpha Bank”. Derisa të paguhej diferenca e shitjes së apartamentit, blerësve nuk u është dhënë në dorë kontrata nga ana ime. Kjo diferencë është shlyer në vitin 2010 dhe meqenëse blerësit e kishin humbur afatin ligjor të regjistrimit të pronës në ZVRPP Tiranë, kemi lidhur një kontratë tjetër shitjeje me nr. 92 rep., nr. 22 kol., datë 20.1.2010, te po e njëjta notere, I. Ç., me të njëjtat palë, me të njëjtin objekt, me të njëjtën vlerë shitjeje. Theksoj se nga ky apartament kam përfituar vetëm një herë vlerën e shitjes prej 90.000 eurosh, nga të cilat janë paguar diferenca e kredisë e raportuar vetëm një herë në ILDKPKI.*”

Pra, subjekti, me këtë deklaram ka pranuar faktin se ai ka kryer një veprim “fiktiv” për të favorizuar palën blerëse. Ky veprim ul reputacionin e një gjyqtari dhe shkakton humbjen e besimit të publikut te drejtësia shqiptare.

Duke analizuar deklaramet, fiktivitetet dhe mospërputhjet e mësipërme, lind pyetja se për çfarë arsyeje subjekti i rivlerësimit (pas dy vitesh që kishte nënshkruar kontratën e parë të premtim-shitjes dhe pasi, – sipas deklaramit të vitit 2008, – ishte paguar totalisht edhe çmimi i kësaj shitblerjeje) duhej që të firmoste një kontratë fiktive dhe të favorizonte blerësit, kur nuk kishte asnjë detyrim ligjor për ta bërë këtë? Madje, duke rrezikuar edhe reputacionin e tij.

Së pari, nuk rezultoi në bazuar shpjegimi i subjektit në lidhje me motivin e ribërjes së kontratës, kur ai deklaroi: “*Meqenëse blerësit kishin humbur afatin ligjor të regjistrimit të pronës në ZVRPP Tiranë, kemi lidhur një kontratë tjetër shitjeje, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.01.2010*”.

Sa është shprehur më lart, – duke përjashtuar hipotezën e mosnjohjes nga ana e subjektit të rivlerësimit të normativave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e regjistrimit, – në rastin më të mirë mund të shihet si një tregues i një përgjigje sipërfaqësore ose, përndryshe, mund të jetë një tentativë e dështuar për t'i bërë Komisionit të besojë dhe të justifikojë një veprim fiktiv me një arsye të mbingarkuar, keqreferuar ose të sajuar. Ky vlerësim bëhet duke pasur parasysh përmbajtjen e ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, i cili në nenin 12 parashikon: *”Nëse një dokument paraqitet për regjistrim më vonë se 30 ditë nga data e realizimit të tij, përveç tarifës së regjistrimit, për çdo ditë vonesë që ka kaluar nga kjo datë, paguhet kamatëvonesë e barabartë me 10 për qind të tarifës së regjistrimit.”*

Pra, ligji e parashikon mjaft qartë faktin që edhe pas kalimit të afatit 30-ditor nga momenti i përpilimit të kontratës së shitblerjes, mund të vijojë të kryhet regjistrimi i një kontrate, duke paguar diçka më shumë. Kështu që deklarimi i subjektit të rivlerësimit *“...meqenëse blerësit e kishin humbur afatin ligjor të regjistrimit të pronës në ZVRPP Tiranë ...”* rezulton i pavërtetë.

Deklarimi i mësipërm nuk qëndron për sa kohë që, sipas ligjit, nuk parashikohet një humbje e afatit ligjor për kryerjen e regjistrimit dhe nuk është korrekt pohimi se *“blerësit nuk mund të regjistrin pronën e tyre, nëse nuk do të firmosej një kontratë e re për premtim shitblerjeje”*. Sipas këtij ligji, ata mund ta regjistrin këtë pronë, por detyroheshin që të paguanin, veç tarifës normale, edhe kamatëvonesën e parashikuar posaçërisht për regjistrimet e vonuara.

2.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me mospërputhjet e deklarimeve mbi këtë pasuri

Në lidhje me problematikat e konstatuara mbi këtë pronësi, subjekti i rivlerësimit sqaroi se:

- Për sa i përket pasaktësisë së datës së kontratës të vitit 2004, ka qenë një lapsus, pra një gabim njerëzor.
 - *Komisioni e pranon këtë shpjegim dhe e konsideron si të tillë, pasi kjo pasaktësi nuk ka passjellë asnjë efekt konkret.*
- Në lidhje me mospërputhjen e çmimit të deklaruar për blerjen e këtij apartamenti (55.000 euro), me atë të pasqyruar në kontratë (4.000.000 lekë), subjekti shpjegoi se ai kishte kryer punime mirëmbajtjeje dhe vlera/çmimi i tregut real ishte ai që ishte deklaruar. Pra, ai kishte dashur të ishte sa më i përpiktë, duke deklaruar vlerën reale të tregut.
 - *Komisioni vëren se, nga ana e subjektit të rivlerësimit mund të ishte specifikuar veçmas çmimi i shitjes nga ai i punimeve të kryera, në të njëjtin formular, pa e mohuar realitetin, por edhe pa e deformuar atë, nëpërmjet pasqyrimit të një vlere që nuk përputhet me atë të firmosur në kontratë.*
- Ndërsa, në lidhje me mospërputhjen e çmimit të deklaruar për shitjen e po të njëjtit apartament (8.400.000 lekë), me atë të pasqyruar në kontratë (90.000 euro), subjekti i rivlerësimit sqaroi se kjo gjë kishte ndodhur pasi ai, edhe këtu, kishte deklaruar shifrën reale që kishte marrë/përfutur atë vit, pasi ai në vitin 2008, kur ishte nënshkruar kontrata e parë e premtim-shitjes, kishte marrë si paradhënie shumë prej 2.5 milionë lekësh. Pra, sipas tij, duke hequr nga çmimi i plotë shifrën e marrë si paradhënie në vitin 2008, ngelej

pikërisht shuma prej 8.400.000 lekësh, që ai kishte marrë në 2010-ën, dhe për harresë e kishte deklaruar në vitin 2011.

-Komisioni vëren se në deklaratën e vitit 2008, çmimi i shitjes në fjalë, i përfituar dhe tërhequr, është deklaruar i plotë (90.000 euro) – madje me një gjendje të ngelur cash prej 60.000 eurosh.

- Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pranoi që kishte nënshkruar një kontratë fiktive, por pa qëllim të keq, pasi ajo i ishte paraqitur si një zgjidhje e situatës për mundësimin e regjistrimit të apartamentit objekt shitblerjeje. Ai specifikoi faktin që çmimin e shitjes e ka përfituar vetëm një herë dhe nuk ka pasur asnjë përfitim tjetër nga ana e tij, në sajë të lidhjes së një kontrate të dytë, me të njëjtat palë, me të njëjtin çmim dhe përpara të njëjtit noter.
-Komisioni vëren se ky veprim dëmton ndjeshëm reputacionin e një gjyqtari dhe për rrjedhojë shkakton/shton humbjen e besimit të publikut te drejtësia shqiptare.

2.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni, mbështetur në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë për Procesin e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike, sipas pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, provat shkresore të administruara, sipas neneve 49 dhe 50 të po këtij ligji, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike, shpjegimet dhe provat e dërguara, si dhe ato të argumentuara në seancën dëgjimore nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në sajë të sa u shpalos në paragrafët e mësipërm, në lidhje me deklaratimet dhe veprimet juridike të kryera mbi pasurinë objekt shqyrtimi, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit:

- a-** Ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit në Rrugën e ***, Tiranë, - të deklaruar të ndryshëm nga sa rezulton në kontratën e datës 25.08.2004.
- b-** Ka paraqitur deklarime të pasakta dhe me përmbajtje të ndryshme nga sa rezulton nga të dhënat e kontratave të nënshkruara prej tij.
- c-** Ka paraqitur deklaram të pamjaftueshëm në Deklaratën-Vetting dhe në mospërputhje me deklaratat periodike, si dhe me deklaratimet e dhëna prej tij në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit.
- d-** Ka paraqitur deklarata periodike të pamjaftueshme dhe të pasakta, pasi rezultojnë në mospërputhje midis tyre, si dhe në kundërshtim me përmbajtjen e kontratave të shitblerjes nga ana e tij (2008 dhe 2010) të apartamentit të sipërcituar, në lidhje me çmimin e aplikuar, me pjesën, mënyrën dhe momentin e pagesës së tij.
- e-** Ka dhënë para Komisionit përgjigje të pavërteta, të ndryshme dhe kontradiktore midis tyre, që nuk përkojnë me realitetin e fakteve të vërtetuara nga dokumentet.
- f-** Ka nënshkruar një kontratë të dytë shitblerjeje, fiktive, për të njëjtin send, vetëm për të favorizuar blerësit që të shmangnin detyrimet me kamatëvonesën që lindte, pikërisht nga vonesa me të cilën mund të ishte bërë regjistrimi i kontratës së parë. Veç të tjerash, Komisioni vlerëson se kontrata e dytë e firmosur nga subjekti i rivlerësimit, në vitin

2010, në mungesë të një revokimi eksplicit të kontratës së mëparshme, rezulton e pavlefshme, për shkak se kontrata e parë, e firmosur në vitin 2008, në bazë të nenit 83 të Kodit Civil, i ka prodhuar të gjitha efektet e veta juridike qysh në momentin e firmosjes së saj përpara noterit, pavarësisht se kur është kryer likuidimi total i çmimit dhe regjistrimi i sendit në ZRVPP⁹.

Në përmbledhje të arsyetimeve të mësipërme, Komisioni arrin në përfundimin se nga analiza dhe vlerësimi i veprimeve juridike dhe deklaratimeve që subjekti i rivlerësimit ka kryer në lidhje me këtë pasuri, rezulton e provuar ekzistenca e veprimeve fiktive dhe e deklaratimeve të pamjaftueshme, kontradiktore midis tyre dhe të paplota, si në Deklaratën-Vetting dhe në ato periodike. Veprime këto që rezultojnë në mosrespektim të ligjit nr. 9049/2003 dhe të ndryshimeve të tij, të etikës së një funksionari të lartë publik, si dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe që për rrjedhojë çojnë në aplikimin e pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ish-pasuri e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit: Apartament prej 83 m², me adresë: Rr. “*”, banesa nr. ***, shk. ***, K. ***, hyrja nr. ***, Bulqizë.**

Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi ekzistenca e një kontrate me nr. 1802 rep., nr. 500 kol., e datës 17.10.2013, me objekt shitblerjen e apartamentit të sipërcituar. Gjithashtu, nga certifikata e vërtetimit të pronësisë së këtij objekti, e datës 12.03.2001, rezultoi se znj. A.L, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, – pasi është bashkëshortja e tij, – kishte qenë bashkëpronare, me pjesë takuese ¼-tën e apartamentit prej 83 m², me adresë: “***”, banesa nr. ***, shk. ***, K. ***, hyrja nr. ***, Bulqizë.

Rezultoi gjithashtu se apartamenti në fjalë ishte shitur nga bashkëpronarët M.S., B.S. dhe bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, te blerësit A. L. dhe të tjerë, me çmim 2.358.860 lekë. Kështu, nga përmbajtja e dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. A. L, kishte qenë bashkëpronare e një apartamenti qysh prej vitit 2001 dhe në vitin 2013 kishte përfituar ¼-tën e vlerës së shitjes së tij (2.358.860 lekë), pra shumën prej 589.715 lekësh.

Duke analizuar deklaratimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, në sajë të kësaj gjetjeje, rezultoi se në deklaratën parë, të vitit 2003, subjekti dhe personi i lidhur me të, nuk e kishin deklaruar fare pasurinë e paluajtshme në fjalë. As në vitet në vijim kjo pasuri nuk është deklaruar, edhe pse bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka vijuar të jetë bashkëpronare e këtij apartamenti deri në vitin 2013.

Gjithashtu, në deklaratën e vitit 2013, vit në të cilin rezulton të jetë kryer shitja e apartamentit në fjalë dhe znj. A.L të ketë përfituar ¼-tën e çmimit të shitjes, si më lart, nuk rezulton të jetë deklaruar shuma prej 589.715 lekësh si e ardhur nga shitja në fjalë, as nga subjekti i rivlerësimit dhe as nga personi i lidhur/bashkëshortja e tij. Po ashtu, kjo shumë e përfituar nuk është deklaruar as në Deklaratën-Vetting.

⁹ Shih Vendimin Unifikues nr. 1/2009 të GJ. L., mbi interpretimin e nenit nr. 83 të Kodit Civil.

3.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me mospërputhjet e deklarimeve mbi këtë pasuri

Në lidhje me mosdeklarimet e sipërpërmendura, subjekti i rivlerësimit i pranoi ato si të tilla. Gjithashtu, ai e shpjegoi këtë mangësi si një zgjedhje të vetën për të qenë ekstremisht i sinqertë dhe për të mos deklaruar diçka që nuk e kishte poseduar asnjëherë dhe që, realisht, familja e tij nuk kishte përfituar asnjë shumë lekësh nga shitja e këtij apartamenti, e realizuar në vitin 2013. Kjo shpjegohej me faktin që subjekti i rivlerësimit kishte preferuar/zgjedhur të respektonte zakonet e zonës së origjinës së bashkëshortes, – zakone që rridhnin nga kanunet e lashtësisë, – sipas së cilave kur një vajzë martohet dhe dilte nga shtëpia, nuk i përkiste më asnjë pjesë dhe asnjë send nga familja e origjinës.

3.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni, mbështetur në deklarimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë për Procesin e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike, sipas pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, provat shkresore të administruara sipas neneve 49 dhe 50 të po këtij ligji, deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike, shpjegimet dhe provat e dërguara, si dhe ato të argumentuara në seancën dëgjimore nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me pasurinë në fjalë, arsyeton se:

Faktet e ekspozuara si më lart, të konstatuara nga Komisioni dhe të pranuar nga subjekti i rivlerësimit, nuk mund të justifikohen nga një gjyqtar, dhe aq më tepër me argumentin e zgjedhjes së vetëdijshme për respektimin e një tradite zakonore, duke mos përmbushur, në këtë mënyrë, me dashje dhe paramendim, detyrimet ligjore. Veç të tjerash, duhet theksuar fakti që në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij i kishin të gjitha mundësitë që të mund të respektonin traditën dhe të silleshin në përputhje me zakonet dhe kanunet – nëpërmjet dhurimit, mospranimit të trashëgimisë së mundshme apo përdorimit të rrugëve dhe instituteve të tjera juridike, që do të mundësonin evitimin e një veprimi apo mosveprimi në kundërshtim me ligjet dhe udhëzimet në fuqi. Shumë lehtë mund të ishte deklaruar kuota e pasurisë që rezultonte në emër të znj. Lazaj, pa krijuar ky veprim asnjë problem në vetvete si pasojë në lidhje me parimet zakonore, të cilat mund të respektoheshin *de facto*.

Gjithashtu, në vitin 2013, mund të ishte bërë deklarimi i shitjes së kësaj pasurie dhe njëkohësisht të bashkëngjitej një deklaratë mbi mospërfitimin e shumës takuese, apo një akt dhurimi i kësaj shume në favor të personave që zakoni i legjitimonte për ta përfituar atë. Kështu, nuk ishte një detyrim përfitimi, por formalizimi i realitetit të fakteve mbi ekzistencën e të drejtave reale, qofshin ato edhe me efekte shkarkuese, pra të mospërfitimit.

Për rrjedhojë, vlerësohet që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor, përgjatë dhjetë viteve, për të deklaruar posedimin e pasurisë në fjalë, dhe më pas,

në vitin 2013, në deklarin e përfitimit monetar të pasqyruar nga kontrata e shitjes së kësaj pasurie.

Së fundmi, bazuar në faktet e sipërpërmendura, si dhe duke bërë një arsyetim konkludues, në lidhje me sa u shpreh më lart, Komisioni arrin në përfundimin se, nga analiza dhe vlerësimi i veprimeve dhe deklarimeve rezulton që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në lidhje me këtë pasuri kanë kryer fshehje të pasurisë, në masën e pjesës takuese, si dhe kanë paraqitur deklarime periodike të pamjaftueshme në vitet 2003 - 2013, si dhe në Deklaratën-Vetting. Këto veprime cenojnë besimin e publikut ndaj drejtësisë shqiptare, si dhe rezultojnë në mosrespektim të ligjit nr. 9049/2003 dhe të ndryshimeve të tij, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, të çojnë në aplikimin e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

4. Pasuri, në ish-bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit: Apartament banimi i ndodhur në lagjen “*”, Vlorë.**

Ky apartament rezultoi i deklaruar në Deklaratën-Vetting si një pasuri e shitur në vitin 2012 dhe për rrjedhojë ai kishte gjeneruar një burim të ardhurash për subjektin e rivlerësimit në këtë vit. Konkretisht, në formularin e deklarimit - “Vetting”, ishte shkruar sa vijon: *“Të ardhura nga shitja e apartamentit të prindërve të mi ku ‘jam’ pronar me 1/3-tën e këtij apartamenti. Ky veprim është kryer me kontratën nr. ***rep., nr. *** kol., datë 03.12.2012, në shumën 330.000 lekë”*.

Nga verifikimi i deklaratës periodike të vitit 2012, nuk rezultoi të ishte bërë deklarimi i kësaj shitjeje, ku duhej të ishte deklaruar pjesa përkatëse e çmimit të shitjes që ishte përfituar nga subjekti i rivlerësimit, pra 1/3-ta e 1.000.000 lekëve, shuma prej 333.000 lekësh.

Ky apartament rezultoi gjithashtu i deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2003, në këtë mënyrë: *“Apartament me pjesë takuese 50 %, i ndodhur në lagjen “***” në Vlorë; burimi nga ligji për privatizimin, vlera zero lekë”*.

Por, nga hetime të mëtejshme të kryera nga Komisioni, rezultoi që ky apartament ishte shitur që në vitin 2001, me kontratën me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.12.2001, me palë shitëse: L. L., K. L. dhe Artan Lazaj, dhe blerës B. H., me objekt: *“Apartament me sipërfaqe 58.6 m², banesa nr. *** , ap. nr. *** , Lagja “***”, Vlorë, ZK *** , me nr. pasurie *** , me çmim shitjeje 1.000.000 lekë”*.

Pra, referuar kësaj kontrate, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë qenë bashkëpronar i këtij apartamenti, me pjesë takuese 1/3-tën, por i shitur që prej vitit 2001, ndërsa në Deklaratën-Vetting, edhe pse kjo kontratë (nr. *** rep., nr. *** kol), deklarohet si e datës 03.12.2012, rezulton se ajo daton në vitin 2001, si dhe nuk është e deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2012.

Për rrjedhojë, kjo pasuri nuk duhej të ishte deklaruar në vitin 2003 dhe as në Deklaratën-Vetting (si burim të ardhurash në vitin 2012), pasi ajo, siç u arsyetua edhe më lart, rezultoi e shitur që në vitin 2001.

4.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me deklarin e kësaj pasurie

Subjekti i rivlerësimit e ka pranuar që deklarimi i kësaj pasurie nuk duhej të ishte bërë as në vitin 2003 dhe as në Deklaratën-Vetting, pasi ky veprim ka qenë pa shkak dhe i gabuar. Ai e ka konsideruar dhe justifikuar këtë deklarim si një *lapsus*.

4.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktin e mësipërm dhe ligji i zbatueshëm

Nga sa më lart, rezulton e provuar me prova shkresore, të firmosura nga vetë subjekti i rivlerësimit, që në Deklaratën-Vetting dhe në deklaratën e vitit 2003 është deklaruar një pasuri që nuk posedohej më, qysh prej vitit 2001. Për rrjedhojë, konstatohet një pasaktësi dhe mospërputhje midis deklaratave të mësipërme dhe të dhënave konkrete të kontratave.

Gjithashtu, kemi të bëjmë me deklarime të rremë në Deklaratën-Vetting, si dhe në deklaratën e vitit 2003, pasi është deklaruar një pasuri në një periudhë kohore që subjekti i rivlerësimit nuk kishte më, prej vitesh, asnjë të drejtë reale mbi atë send.

Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit nuk janë bindëse, pasi kjo pasuri është deklaruar dy herë, - duke mos bërë një pasqyrim korrekt të realitetit faktik. Është e vërtetë që shumëkush mund të gabojë – në sajë të një *lapsusi* – gjatë transkriptimit të të dhënave që kopjon nga një tjetër dokument, aq më tepër kur bëhet fjalë për një datë. Në këtë këndvështrim, mund të kuptohet dhe tolerohet një *lapsus*, siç është faktikisht ndryshimi i paraqitur në deklarimin e subjektit të rivlerësimit, si më lart, midis shifrës 2012 dhe 2001.

Por, në rastin konkret vërehet diçka më shumë. Përpara sesa të procedohet me plotësimin e një formulari, mendohet/prezumohet se subjekti i rivlerësimit përzgjedh dokumentacionin përkatës për ta pasqyruar në të, dhe këtu qëndron dyshimi mbi përzgjedhjen e gabuar të një dokumenti që nuk mund të përdoret, si bazë mbi të cilin të deklarohet posedimi i një pasurie apo një burim financiar, në sajë të shitjes së saj – në një moment që nuk ishte më në pronësi të tij prej më shumë se 10 vitesh.

Parë në këtë këndvështrim, nuk mund të konsiderohet thjesht një transkriptim i gabuar, me një gabim materialo-njerëzor, por një vlerësim i gabuar paraprakisht në përzgjedhjen e dokumentacionit që do të duhej të pasqyrohej në formularin e deklarimeve përkatëse. Për rrjedhojë, rezulton një mospërputhje midis përmbajtjes së deklaratave dhe të dhënave konkrete të kontratave, dhe për pasojë kemi dy deklarime të rreme, si në Deklaratën-Vetting, po ashtu edhe në deklaratën e vitit 2003. Këto deklarime rezultojnë në mosrespektim të ligjit nr. 9049/2003 dhe të ndryshimeve të tij, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, të çojnë në aplikimin e pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

5. Tokë kullotë, me sipërfaqe 1.000 m², në *, Himarë**

Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri në Deklaratën-Vetting, të blerë me kontratën e datës 21.08.2013, nr. *** rep., nr. *** kol., në vlerën prej 200.000 lekësh. Por, në atë deklaratë nuk rezulton të jetë plotësuar pjesa ku pasqyrohet burimi i krijimit, ndërkohë që kjo kërkohet nga

vetë rubrika “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit” te formulari, po ashtu e njëjta mangësi konstatohet dhe te deklaratat periodike e vitit 2013.

Gjithashtu, në Deklaratën-Vetting rezulton e deklaruar si pjesë takuese ¼-ta (pa e përcaktuar se cilët janë pjesëtarët e tjerë), ndërkohë që nga kontrata e shitblerjes rezulton si palë blerëse e kësaj pasurie vetëm subjekti i rivlerësimit. Ndërsa, duke iu referuar deklaratës periodike të vitit 2013, në deklarimin të kësaj pasurie, ku shkruhet “blerje sipërfaqeje toke kullotë, 1000 m². në ***”, rezulton se pjesa takuese e deklaruar është 100 %.

5.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me pasaktësitë e deklarimit të kësaj pasurie

Subjekti i rivlerësimit e ka pranuar që ka pasur pasaktësi në pjesët takuese të deklaruara, si në lidhje me këtë pasuri, por edhe me të tjera. Ai e ka shpjeguar këtë me faktin që, duke qenë se familja e tij përbëhet nga katër persona, ai gjithmonë i ka menduar dhe i ka konsideruar të gjitha pasuritë që posedon, si takuese prej 25 % për secilin, pasi ato hyjnë të gjitha në bashkësinë familjare, përderisa janë krijuar pas lidhjes së martesës.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka pohuar se gabimi ose mangësia e tij konsiston në mosformalizimin e kësaj ndarjeje të pasurisë në katër pjesë edhe në zyrat kompetente.

5.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktin e mësipërm dhe ligji i zbatueshëm

Për sa më sipër arsyetuar, si dhe duke pasur parasysh faktin që mospërputhjet në fjalë, përveçse janë të provuara nga dokumentacioni i sipërpërmendur, janë pranuar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit.

Rezulton se në formularin përkatës nuk është deklaruar, burimi i të ardhurave, për rrjedhojë jemi përballë një deklarimi të paplotë, që mund të hedhë dyshime mbi ekzistencën e pasjes ose jo të burimeve financiare në momentin e blerjes.

Gjithashtu, për sa i përket pjesës së pronësisë takuese, nga momenti që nga kontrata e blerjes rezulton vetëm një pronar, në mungesë të ndonjë ndryshimi formal të mëtejshëm mbi të drejtat reale mbi sendin në fjalë, nuk mund të konsiderohet korrekt deklarimi i pjesës takuese të pronësisë vetëm për 25 %.

Pra, jemi përballë mosdeklarimit të burimit financiar dhe pasqyrimin të të dhënave pasurore jo të sakta dhe për rrjedhojë janë kryer deklarime të pamjaftueshme në Deklaratën-Vetting, por edhe në atë të vitit 2013, të cilat rezultojnë në mosrespektim të ligjit nr. 9049/2003 dhe të ndryshimeve të tij, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, dhe çojnë në aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

6. Automjeti “Mercedes-Benz”, C 200, viti i prodhimit 1997, *, në ish-pronësi të subjektit të rivlerësimit.**

Duke iu referuar kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.2010, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte blerë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve automjetin e markës “Mercedes-Benz”, tipi C 200, viti i prodhimit 1997, me çmim 125.000 lekë.

Ndërsa nga kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.09.2015, u konstatua se subjekti i rivlerësimit e kishte shitur autoveturën në fjalë me çmimin prej 5.000 eurosh.

Gjithashtu, rezultoi se pala blerëse, në momentin e blerjes kishte deklaruar se: *“Ka marrë në dorëzim këtë mjet, më datë 29.09.2015, ora 11:00; se merr përsipër transferimin e pronësisë në emër të tij dhe, në rast të kundërt, nëse nuk bëhet i mundur transferimi i pronësisë, e merr automjetin për pjesë këmbimi”*.

Nga sa më lart, lindën dyshime të arsyeshme se çmimet e mësipërme nuk pasqyrojnë realitetin, pasi midis këtyre çmimeve, të shitblerjes së autoveturës së sipërpërmendur dhe çmimeve mesatare të tregut, ka një diferencë të konsiderueshme. Gjithashtu, konsiderohet anormal fakti që një autoveturë, pas pothuajse pesë vitesh përdorimi dhe natyrisht amortizimi, mund të kushtojë mbi pesë herë më shumë sesa është blerë.

Në lidhje me këtë pikë, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se kjo ka ndodhur pasi ai, në cilësinë e antarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në vitin 2010, ka privatizuar një automjet, sipas një VKM-je të posaçme. Ai pranoi, gjithashtu, se e kishte blerë autoveturën e sipërpërmendur me një çmim shumë më të lirë se ai i tregut, por aplikimi i këtij çmimi – sipas tij – kishte ardhur sepse ajo kishte 118.000 kilometra dhe më vonë, ajo ishte shitur me 120.000 kilometra. Për sa i përket çmimit me të cilin e kishte shitur atë, ai tha se mund të kishte qenë edhe nën mesataren e tregut, duke pasur parasysh edhe faktin që ajo autoveturë kishte pasur shërbime të mira dhe që kishte motor ekstra, impiant gazi, goma antiplumb etj., dhe për rrjedhojë vlera ishte e larë.

Në lidhje me këto veprime juridike, ngelin dyshimet mbi shkakun e përfitimit të një automjeti, në vitin 2010, me një çmim shumë herë më të lirë se ai i tregut, – siç u pohua edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, – si dhe mbi përputhshmërinë e çmimit të shitjes, në vitin 2015, me atë të tregut. Gjithsesi, nga sa më lart, rezulton që në procesin e privatizimit, pra të blerjes së autoveturës, ka pasur një trajtim preferencial, të padeklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit në formularin përkatës, faqe nr. 6, të deklarimit të pasurisë, dhe për rrjedhojë një deklaram të pamjaftueshëm.

7. Mungesë deklarimi të disa shpenzimeve dhe mosjustifikim të burimeve financiare për pagimin e tyre.

Në sajë të hetimeve të kryera nga Komisioni dhe të vlerësimit të përgjigjeve që subjekti i rivlerësimit ka dhënë në pyetësorët që i ishin nisur atij, është konstatuar se:

a - Për vitin akademik 2016-2017, subjekti i rivlerësimit kishte paguar shumën prej 6.600 eurosh për shkollimin e vajzës. Pagesa është kryer në dy këste, përkatësisht kësti i parë prej 4.800 eurosh më datë 13.09.2016 dhe kësti i dytë prej 1.800 eurosh më datë 11.05.2017.

b - Në deklaratën periodike të vitit 2015 nuk rezulton që nga subjekti i rivlerësimit të jetë deklaruar si shpenzim shuma prej 1.700 eurosh¹⁰.

c - Ndërsa, referuar deklaratës periodike të 2016-ës, nuk rezulton që të jetë deklaruar, si shpenzim shkollimi, shuma prej 3.780 eurosh¹¹ dhe as shuma prej 4.800 eurosh¹². Pra, në total

¹⁰ Kësti i parë për atë vit shkollor.

¹¹ Kësti i dytë për klasën e nëntë.

¹² Pagesa e kështit të parë për klasën e 10-të.

nuk është deklaruar shuma prej 10.280 eurosh si shpenzime për shkollim e vajzës dhe për rrjedhojë nuk është deklaruar as burimi e të ardhurave, me të cilat është mundësuar përballimi i këtyre shpenzimeve.

d - Gjithashtu, shpenzimet e mësipërme nuk rezultojnë të deklaruara as në përgjigjet e pyetësorit të datës 26.12.2017, ku i pyetur specifikisht, ai e ka mohuar këtë fakt.

Në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit e ka pranuar mosdeklarimin e shpenzimeve të listuara më lart. Ai i ka shpjeguar këto mangësi si “*harresa dhe neglizhenca*”, por – sipas tij – ato përbëjnë vetëm pasaktësi dhe jo deklarim të rremë. Gjithashtu, ai ka pohuar se shpenzimet në fjalë janë paguar me të ardhura nga burime të ligjshme, nga puna e tij dhe e bashkëshortes.

Në konkluzion vlerësohet se, në lidhje me shpenzimet e lartpërmendura, janë bërë deklaratat të pamjaftueshme në deklaratimet periodike të viteve 2015, 2016 dhe 2017, si dhe janë dhënë përgjigje të pavërteta, devijuese dhe të paplota ndaj Komisionit. Ky qëndrim mohues i një gjyqtari, përgjatë komunikimit me Komisionin, cenon etikën e tij, si dhe besimin e publikut tek institucionet e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë. Gjithsesi, edhe në lidhje me këtë pikë, ndodhemi përballë pasqyrimin të të dhënave pasurore jo të sakta nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, rezultojnë të jenë kryer deklarime të pamjaftueshme në deklaratat si më lart, të cilat rezultojnë në mosrespektim të ligjit nr. 9049/2003 dhe të ndryshimeve të tij, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe që çojnë në aplikimin e pikës 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

8. Rezultatet e analizës financiare

Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka kryer analizën financiare, duke u bazuar në sa më poshtë:

- a-** Deklarimet e bëra ndër vite nga ana e subjektit të rivlerësimit, pranë ILDKPKI-së;
- b-** Provat shkresore të administruara nga ana e ILDKPKI-së;
- c-** Dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit;
- d-** Deklarimet e bëra nga ana e subjektit të rivlerësimit, përmes postës elektronike, gjatë hetimit administrativ të kryer nga ana e KPK-së;
- e-** Provat shkresore të administruara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, nga institucione publike dhe private;
- f-** Analizën financiare të bërë nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;
- g-** Çdo dokument që përbën mjet prove sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016.

Rezultatet e përmbledhura, të arritura nëpërmjet analizës financiare, janë pasqyruar në tabelën që vijon:

Vitet	Të ardhurat	Ndryshimi i pasurisë	Detyrimet	Pasuria neto	Shpenzimet	Diferenca
2004	954.820	4.002.516	3.500.000	502.516	732.997	-280.693
2005	1.267.238	165.609	(350.000)	515.609	1.000.148	-248.519
2006	1.269.279	191.911	(350.000)	541.911	1.443.364	-715.996
2007	2.142.268	141.967	(350.000)	491.967	1.123.455	526.846
2008	9.014.634	5.107.556	(2.450.000)	7.557.556	1.723.417	-266.339
2009	2.774.115	6.576.783	4.085.490	2.491.292	970.460	-687.637
2010	3.068.705	1.752.681	(258.703)	2.011.384	1.144.653	-87.333
2011	2.006.147	7.682.387	6.746.861	935.526	1.061.532	9.088
2012	2.661.792	1.862.257	(241.090)	2.103.347	1.287.714	-729.269
2013	2.937.980	870.585	(241.090)	1.111.676	1.512.321	313.983
2014	2.682.434	899.697	(241.090)	1.140.788	1.892.362	-350.716
2015	3.179.262	419.616	(201.157)	620.773	1.889.577	-668.912
2016	1.844.661	608.899	(201.157)	810.056	2.553.197	-1.518.592
Totali	35.803.334	30.282.464	9.448.063	20.834.401	20.280.912	-3.366.264

Pra, nga analiza financiare për periudhën 2003 - 2016 rezulton se të ardhurat e ligjshme të realizuara nga subjekti i rivlerësimit nuk kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar blerjet e pasurive të paluajtshme, kursimet, pra gjendjen e likuiditeteve në bankë dhe *cash* në shtëpi, si dhe për të kryer shpenzimet jetike dhe ato të deklaruara.

8.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me analizën financiare

Në lidhje me të dhënat e lëvruara në analizën financiare, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet *e-mail*-it të datës 21.06.2018, si dhe në seancën dëgjimore, paraqiti disa vërejtje të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, në lidhje me: i) shpenzimet e mobilimit të apartamentit të tij prej 9.000 eurosh, të kryera nga shoqëria “***.” sh.p.k.; ii) disa të ardhura (800.000 lekë) të realizuara nga bashkëshortja e tij në vitin 2009, – pa provuar pagesat e detyrimeve tatimore mbi ato; iii) shpenzimet e sponsorizuara në lidhje me një udhëtim për arsye profesionale, të kryer në periudhën 29 prill - 1 maj 2016; iv) shpenzimet e një udhëtimi familjar në SHBA, në periudhën 23 gusht - 8 shtator 2016, të paguara nga vëllai i subjektit të rivlerësimit (z. K.L.).

Sa më lart u analizua, u vlerësua dhe u mor në konsideratë nga Komisioni, duke i reflektuar efektet e tyre në rezultatet financiare të viteve respektive, me përjashtim të fitimeve të pretenduara për vitin 2009 nga kompleksi “***.” në Gjirokastrë, pasi ato nuk përmbushin kriteret e parashikuara nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit bëri referim mbi fitimet dhe kursimet e tij dhe të bashkëshortes së tij në periudhën para vitit 2003, periudhë në të cilën shpenzimet jetike kishin qenë minimale. Në lidhje me këtë kërkesë, Komisioni i bëri me dije subjektit të rivlerësimit se ato kursime mund të merreshin në konsideratë për shpenzimet e kryera deri në datën 31.12.2003. Për sa i përket

periudhës së mëpasshme, ato mund të përllogariteshin si një burim financiar i disponueshëm për aq sa (mund të) ishin deklaruar si kursim i mbartur në çdo fundviti, nëpërmjet deklaratës së pasurisë respektive.

Në sajë të rezultateve financiare të pasqyruara më lart, konstatohet një mungesë e theksuar aftësie paguese, të ardhurash nga burime financiare të ligjshme, në vitet 2004; 2005; 2006; 2009; 2010; 2011; 2012; 2014; 2015; 2016, që të mund të ishin të mjaftueshme për të përballuar të gjitha shpenzimet e kryera nga familja e subjektit të rivlerësimit në periudhat respektive, si dhe për të realizuar kursimet e deklaruara.

Si konkluzion, në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, pasi trupi gjykues konstatoi se:

- i) *Nuk është deklaruar shpenzimi prej 4.900.000 lekësh, i kryer në vitin 2009 dhe as ai prej 50.000 eurosh i bërë në vitin 2010 – të dy në favor të “***” sh.p.k.*
- ii) *Nuk kishte burime financiare të ligjshme në datën 18 gusht 2010 për pagesën e 50.000 eurove, pasi të ardhurat nga shitja e shtëpisë, e kryer më 19 nëntor 2010, ishin të disponueshme tre muaj më vonë.*
- iii) *Mungesë deklarimi të gjendjes cash prej 50.000 eurosh dhe të burimit të tyre. Kjo sasi likuiditeti duhej të ishte deklaruar gjendje cash e mbartur në datën 31.12.2009, pra në deklaratën e këtij viti, me specifikimin e burimit të kësaj shume, duke u nisur nga fakti që në datën e kryerjes së pagesës në fjalë nuk disponohej ende shuma e përfituar nga shitja e apartamentit në Rrugën ***, Tiranë.*
- iv) *Është bërë deklaratë e rreme në vitin 2008, kur në faqen nr. 3 është deklaruar një gjendje cash 60.000 euro – si pjesë e ngelur nga shuma prej 90.000 eurosh, e përfituar nga shitja e apartamentit (pasi: ishin paguar taksat; ishte shlyer kredia në “Alpha Bank”; ishte blerë një autoveturë).*
- v) *Nuk janë deklaruar pagesat (që pretendohet) që janë kryer në favor të “***” sh.p.k., përgjatë periudhës 2010 - 2014, – sipas deklaratës së kësaj të fundit, të datës 21.03.2018, – të detyrimit prej 50.543 eurosh (të ngelur nga çmimi i blerjes së apartamentit: $129.000 - 28.457 - 50.000 = 50.543$).*
- vi) *Ka mospërputhje midis deklaratës së “***” sh.p.k., të datës 21.03.2018, të cilën subjekti i rivlerësimit e konfirmon, duke iu referuar asaj dhe duke mbështetur në të disa argumentime të tij, dhe veprimeve të kryera, si dhe deklarimeve periodike në të cilat nuk është specifikuar mënyra/vlera/viti i pagesave (e kësteve të pretenduara).*
- vii) *Ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit në Rrugën ***, Tiranë, të deklaruar të ndryshëm nga sa rezulton në kontratën e datës 25.08.2004.*
- viii) *Ka paraqitur deklarime të pasakta dhe me përmbajtje të ndryshme nga të dhënat e kontratave të nënshkruara prej tij.*
- ix) *Ka paraqitur deklarim në Deklaratën-Vetting të pamjaftueshëm dhe në mospërputhje me deklaratat periodike, si dhe me deklarimet e dhëna prej tij në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit.*

- x) *Ka paraqitur deklarata periodike të pamjaftueshme dhe të pasakta, pasi rezultojnë në mospërputhje midis tyre, si dhe me përmbajtjen e kontratave të premtim-shitjes nga ana e tij (2008 dhe 2010) të apartamentit të sipërcituar, në lidhje me çmimin e aplikuar, me pjesën, mënyrën dhe momentin e pagesës së tij;*
- xi) *Ka dhënë para Komisionit përgjigje të pavërteta, të ndryshme dhe kontradiktore midis tyre, që nuk përkojnë me realitetin e fakteve të vërtetuara nga dokumentet.*
- xii) *Ka nënshkruar një kontratë të dytë premtim-shitjeje, fiktive, për të njëjtin send, vetëm për të favorizuar blerësit që të shmangnin detyrimet e kamatëvonesës që lindte, pikërisht nga vonesa me të cilën mund të ishte bërë regjistrimi i kontratës së parë.*
- xiii) *Është kryer fshehje e pasurisë, në masën e pjesës takuese, si dhe e deklarimeve periodike të pamjaftueshme në vitet 2003 - 2013, dhe në Deklaratën- Vetting.*
- xiv) *Rezulton një mospërputhje midis deklaratave dhe të dhënave konkrete të kontratave, si dhe dy deklarime të rreme, si në Deklaratën-Vetting, po ashtu edhe në deklaratën e vitit 2003.*
- xv) *Janë bërë deklarata të pamjaftueshme në deklaratimet periodike të viteve 2015, 2016 dhe 2017, si dhe janë dhënë përgjigje të pavërteta dhe të paplota ndaj këtij Komisioni.*
- xvi) *Në periudhën 2003-2016 rezulton se të ardhurat e ligjshme të realizuara nga subjekti i rivlerësimit nuk kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar blerjet e pasurive të paluajtshme, gjendjen e likuiditeteve në bankë dhe cash në shtëpi, si dhe për të kryer shpenzimet jetike dhe ato të deklaruara.*
- xvii) *Mungesë e theksuar gjendje të ardhurash nga burime financiare të ligjshme, në vitet 2004; 2005; 2006; 2009; 2010; 2011; 2012; 2014; 2015; 2016, që të mund të ishin të mjaftueshme për të përballuar të gjitha shpenzimet e kryera nga familja e subjektit të rivlerësimit në periudhat respektive, si dhe për të realizuar kursimet e deklaruara.*

Konkludon se:

Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk ka dhënë shpjegime bindëse, referuar pikës 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

Në këto kushte Komisioni, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, vendosi që subjektit të rivlerësimit, z. Artan Lazaj, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenet 179/b, “D”, pikat 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe të nenit 61, pika 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Lazaj, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 11.07.2018.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Brunilda Bektoshi
Kryesuese

Lulzim Hamitaj
Relator

Olsi Komici
Anëtar

Sekretare gjyqësore

Denisa Kosta